



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 584 Prot

Tiranë, më 25.03.2019

Nr. 1301 Dosje

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 2259 Regj.Them, të lëshuar më datë 17.01.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1301, Datë 07.03.2019 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut I.SH.M.T, ndaj debitorit Shoqëria “ANTENA” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K41622008B, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr. 67/2, datë 12.02.2018.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 454 Prot, Datë 08.03.2019 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 2259 Regj.Them, Datë 17.01.2019, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori Shoqëria “ANTENA” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K41622008B, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet e debitorit Shoqërisë “ANTENA” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K41622008B në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.



Për sa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i I-re) të Ligjit Nr.10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, si dhe Nenit 39 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”

URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
 - a) Shoqëria “ANTENA” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K41622008BDhe
 - b) Z. Emanouil Papadopoulos (atësia: Jorgo, i datëlindjes: 23.09.1978), mbajtës i pasaportës Greke me Nr. M 911684.
2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) qe parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri
6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO

